




REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT

MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



Drejtoria për Arsim- Deçan

07 Nr.

Dt. 29.10.2018

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, neni 18 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 3 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit mbi Shërbim Civil, dispozitave të Ligjit të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, dispozitave të nenit 5 pika (d) të Ligjit për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, si dhe konform nenit 2 pika 1 – 9 dhe nenit 3 të Udhëzimit Administrativ nr.08/2014 nga MASHT, Drejtoria për Arsim në Deçan, shpall :

K O N K U R S

Për zgjedhjen e drejtorit të këtij institucioni të arsimit publik në komunën e Deçanit.

Institucioni : 1.. SH.F.M.U. “ **Faik Konica** ” –Ratish.

Drejtoria : Drejtoria për Arsim në Deçan

Titulli i vendit të punës : Drejtor shkolle

Kategoria funksionale/ Grada 7.8

Lloji i punës : Jo i karrieres (me kohë të caktuar – mandat)

KUSHTET : Kandidatët e interesuar për të konkurruar për drejtor në këtë shkollë duhet ti plotësoj këto kushte :

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
2. Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësim dhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore..
3. Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit.
4. Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim .
5. Të kenë më së paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucionet e arsimit.
- 6. Të posedojnë këto dokumente :**
 - 6.1. Çertifikatën e lindjes.
 - 6.2. Letërnjoftimin kopje.

- 6.3. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës.
- 6.4. Dëshminë për përvojën e punës.
- 6.5. Portfolion profesionale
- 6.6. Letër-referencë nga një institucion publik kredibil (si Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë).
- 6.7. Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punë dhe angazhimet paraprake.
- 6.8. Planin zhvillimor të Institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5 fronti i shkronjave 12 arial). sipas Udhëzimeve të MASHT.
- 6.9. Çertifikatat e trajnimeve të zhvilluara.
- 6.10. Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore.
- 6.11. Dëshminë se nuk është nën hetime.

Marrëdhënia e punës krijohet përmes kontratës, në pajtim me ligjet në fuqi dhe zgjatë 4 vjet.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do të nështrohen testit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50 % të vlerësimit përfundimtar.

Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në këtë pozitë.

Për intervistë fo të ftohen ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore dhe nënligjore.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test, intervistë si dhe orari i intervistave publikohet në ueb faqen e komunës së Deçanit :<https://kk.rks-gov.net/decan/>.

Kandidatët e interesuar për konkurrim gëzojnë të drejtën e konkurimit në konkurs brenda 15 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga dt.30.10.2018 e deri me dt.13.11.2018.

Aplikacionet për konkurrim merren dhe dorëzohen në zyrat pritëse të komunës së Deçanit.

 KOMUNA E DEÇANIT - DEÇAN MUNICIPALITY	
Nr. i regjistruar: Nr. i dërguar: Nr. i pranuar: Nr. i pagesë:	Nr. i regjistruar: 33837 Nr. i dërguar: 07 Nr. i pranuar: Nr. i pagesë:
Data: 29.10.18 Data: 20	

Drejtori,
 Qazim Maloku

